



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Ministria e Zhvillimit Rajonal shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të marrëdhënieve me publikun dhe informimin
Titulli i pozitës së punës	Zyrtar për Komunikim me Publikun
Klasa e pozitës	Profesional 2
Koeficienti/Paga	5.2
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	15/02/2024
Afati për aplikim	16/02/2024 - 16/03/2024
Institucioni	Ministria e Zhvillimit Rajonal
Departamenti	Zyra e Sekretarit
Divizioni	Divizioni për Komunikim Publik
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00013349
Kodi	RPC0006888



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Menaxhon, administron dhe zhvillon ueb faqen e ministrisë dhe siguron qasje të lehtë dhe kualitative për vizitorët si dhe siguron që përmbajtja e ueb faqes të ruan shikueshmërinë.
2. Siguron furnizimin dhe përditësimin e ueb faqes me materialet në dispozicion si, tekste, foto, video për të siguruar ndikimin e saj dhe interesimin për audiencën.
3. Menaxhon me posten elektronike zyrtare të ministrisë për komunikim me publikun dhe është përgjegjës për shërbime tjera elektronike;
4. Bashkëpunon me njësinë për teknologji informative lidhur me zhvillimin dhe mirëmbajtjen e ueb faqes së ministrisë;
5. Në bashkëpunim me Udhëheqësin ndihmon në përgatitjen e raporteve 3 mujore, 6 mujore dhe vjetore për zbatimin e Ligjit për qasje në Dokumente Publike;
6. Ndhmon në përgatitjen e kumtesave, informatave, raporteve dhe publikimeve tjera për publikun,;
7. Ndhmon në pranimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, evidenton kërkesat dhe i përcjell tek burimet përkatëse të cilët duhet të përgjigjen;
8. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.



3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve: Gazetari/Shkenca Komunikimi, Gjuhë dhe Letërsi, Marrëdhënie me Publikun, Marketing.
- **Kualifikime të posaçme formale:**
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.



5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendimit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkëngjiten edhe dëshmitë e trustit,
- Trusti duhet të jetë në përputhje të plotë me kontratat që dëshmojnë përvojën e punës.
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Kopjen e letërnjoftimit /pasaportës e lëshuar nga Republika e Kosovës,
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende (vlenë vetëm për zyrtarët publikë);
- Kopja e dëshmisë se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore dhe dëshmia se kandidati nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale me dashje, dorëzohen gjatë fazës së verifikimit para emërimit.
- Dëshminë (vet deklaratën me shkrim) se kandidatët i përkasin komunitetit joshumicë.

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 31/03/2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Kuotat e rezervuara dhe masat afirmative: Pozita është e paraparë vetëm për komunitetet joshumicë, me qëllim të plotësimit të Kuotës së rezervuar për komunitetet jo shumicë në shërbimin civil në institucionet e administratës qendrore.
- Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj, andaj inkurajohen për aplikim.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.
- Kandidati përmes aplikimit deklaron dhe mbanë përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohet nga shpallja e procedurës së rekrutimit,
- Bazuar në nenin 14 Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për procedurën e pranimit në Shërbimin Civil, NJBN pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, bënë verifikimin përfundimtar para emërimit të plotësimit të kritereve të aplikimit nga kandidati dhe kërkon kandidatit paraqitjen e dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kritereve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LQP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

